



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Data: ____/____/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

:

OBJEKTI I PROKURIMIT : “Nderhyrje Mirembajtese ne Infrastrukturen e Tregut Industrial”- Berat

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) : CPV):
45000000-7 Punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT : 14 866 922.29 (katermbedhete milion e teteqind e gjashtedhete e gjashte mijë e nenteqind e njezete e dy presje njezete e nente) leke pa Tvsh

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar **projekt preventivit**.

Fondi limit eshte percaktuar ne baze te preventivit te punimeve te hartuar nga specialistet e fushes me objekt “Nderhyrje Mirembajtese ne Infrastrukturen e Tregut Industrial”- **Bashkia Berat**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Berat (Njësia e Prokurimit), bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, projekt – preventivin dhe grafikun e punimeve, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3; ;.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, bëhet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin e fundit (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 - 1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 - 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 2. Situacionin përfundimtar të objektit;
 3. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë;

N.P-3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

N.S.-1 A Punime per prishjen e ndertimeve

N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike

Shënim : *Operatorët e huaj duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucionit përkatës siç përcaktohet në “Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e miratuar me VKM – në Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Mos paraqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi

dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

-Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Licencat për punimet e përgjithshme të ndërtimit dhe punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë :

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P.3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv si punime hidroizolimi, punime suvatimi, punime hekuri dhe betoni	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.S - 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv në seksionin A. "PUNIME PRISHJE",	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

N.P – 1 A	Punime gërmimi në tokë	Ne kete kategori perfshihet grupzeri - Punime Germimi , si shkak i germimit per rehabilitimin e linjave KUZ	Punime gërmimi në tokë	Ne kete kategori perfshihet grupzeri -Punime dheu
N.S - 4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues	Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, punime konstruksione metalike, punime bojatisje, punime mbulese sandwich, punime montim xhami etj..)	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
NS-2 A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Ne kete kategori perfshihet grup zeri – Instalime hidrosanitare dhe ngrohje	INSTALIME HIDRAULIKE	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik per secilin pjesetar te stafit teknik duhet te paraqese:

Kontratë pune/, Diplomën Universitare,

(Drejtuesit teknik te jene te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi për periudhën muajin e fundit .

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me dëshmi profesionale të leshuara nga shoqëria të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht më poshtë :

- Specialist në montimin e konstruksioneve metalike, mbulesa metalike 2 (dy)
- Hidraulik 2 (dy)
- Specialist Suvaje 1 (nje)
- Specialist pllakashtrues 1 (nje)
- Bojaxhi 1 (nje)
- Punetore të thjeshtë ndertimi 2 (dy)
- Shofer 1 (nje)
- Manovrator 1(nje)
- Teknik ndertimi 1(nje)

12 puntore

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme, germa b) janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

-Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve,

Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor inxhinieri nderimi, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës së

kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Hartimi i këtyre kriterëve është vendosur edhe mbi bazën e parashikimeve të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas të cilës, “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Gjithashtu, hartimi i kriterëve për personelin kryesor si dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar është hartuar në përputhje me nenin 39/6/c/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri Ndërtimit (nje)** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të rikonstruktohet për secilin nga zërat e punimeve, konkretisht zërave të punimeve të parashikuara në preventiv në seksionin (Punime te brendshme ndertimore, arredime te brendshme).
- **Teknik ndërtimi (nje)** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Specialist ne montimin e konstruksioneve metalike (dy)** , Operatori ekonomik duhet të disponojë dy specialistë të kualifikuar për montimin e konstruksioneve metalike, të cilët garantojnë realizimin korrekt të lidhjeve dhe stabilitetin e strukturës sipas projektit. Prania e dy specialistëve është e domosdoshme për të siguruar cilësinë e punimeve, kontrollin teknik të vazhdueshëm dhe respektimin e standardeve të sigurisë gjatë gjithë procesit të montimit.
- **Hidraulik (dy)** Operatori ekonomik duhet të disponojë dy hidraulikë të kualifikuar për punime KUZ dhe instalime hidrosanitare, për të garantuar zbatimin korrekt të rrjetit të kanalizimeve dhe sistemeve të ujësjellësit sipas projektit. Prania e dy hidraulikëve është e domosdoshme për të siguruar vazhdimësi të punimeve, kontroll të cilësisë dhe funksionim të saktë të instalimeve hidraulike gjatë fazave të zbatimit dhe testimit.
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e volumit te punimeve te ndertimit sipas preventivit me 300 m2 lyerje.

- **Specialist Suvaje (nje)** Operatori ekonomik duhet të disponojë një specialistë suvatimi për trajtimin e mureve dhe tavaneve me lagështi, për të siguruar përgatitjen e duhur të sipërfaqeve dhe aplikimin korrekt të shtresave të suvave sipas kushteve teknike.
- **Specialist ne shtrimin e pllakave (nje)** Operatori ekonomik duhet të disponojë një specialist për shtrimin e pllakave, për të garantuar vendosjen e saktë, nivelimin dhe realizimin cilësor të punimeve sipas specifikimeve teknike të projektit.
- **Puntor te thjeshte ndertimi (dy).** Kerkohen dy per te qene ndihmes ne punimet e pusetave dhe kanalizimeve
- **Shofer** per drejtimin e mjeteve te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.
- **Manovrator** per drejtimin e mjeteve te nevojshme per ekzekutimin e punimeve. (ne drejtimin e vincit per punimet ne lartesi te konstruksioneve metalike dhe xhamave te temperuar)

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projekt preventivuesi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 13 (trembedhjetë) punonjës. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët

ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzoj pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, , për periudhën muajin e fundit*
- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projekt preventivuesi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit. Bazuar në numrin e punëtorëve të kërkuar dhe numrin e inxhinierëve del në përfundim një nr prej 13 punonjësish të kërkuar për këtë procedurë prokurimi.

Nr	PUNIMET	ORE PUNE	DITE PUNE	PUNTORE/132 dite
1	Punime Prishje	500	62.5	2
2	Punime Suvatimi	340	42.5	
3	Punime Konstrukione Metalike	1200	150	2
4	Punime Shtresash/Pllaka	300	37.5	1
5	Punime Bojatisje	120	15	1
6	Punime Mbulimi Me Panele Sanduich	3500	437.5	2
7	Punime Hidraulike Dhe KUZ	1000	125	2
11	Punime Te Tjera Te Imta	2300	287.5	
12	Makineri	1500	187.5	2
		10760	1345	12 PUNTORE

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

1 (një)punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

- Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për *sigurinë në* kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga zjari apo çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Kamioncin veteshkarkues	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Minifadrom me goma Bobcat	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Kokore	Cope 14	Ne pronesi ose me qera
Matrapik per thyerje betoni	copë 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
Skela metalike	500 m2	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalistike	Cope 2	Ne pronesi ose me qera

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Kamion me vinc: Për ngritjen dhe montimin e elementeve metalike dhe paneleve sandwich I domosdoshëm për punë në lartësi dhe elemente të rënda
- Kamioncin vetëshkarkues— Për transportin e materialeve (hekur, xhama, panele., etj.) Shkarkim i shpejtë në kantier pa humbje kohe
- Minifadrom me goma: Për pastrim kantieri dhe lëvizje materiale. Për nivelime dhe punime ndihmëse në terren të ngushtë
- Kokore Jane mjete mbrojtëse për punonjësit që do të punojnë në kantier.
- Matrapik për thyerje betoni: Për prishje të pjesëve ekzistuese të dëmtuara. Për hapje apo modifikime në strukturat e betoni
- Skela metalike Për punime në lartësi (mbulim, xham, ulluqe) Garantim i sigurisë dhe aksesit të punëtorëve
- Tabela sinjalistike Sinjalistika në Objekt: e domosdoshme për njoftimin dhe zbatimin e rregullave të sigurimit Teknik në objekt..

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik fitues, para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikatën e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), leshuar nga organet kompetente në emer të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë

fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet janë bazuar në zërat e punimeve dhe mundësinë për të patur akses në sheshin e ndertimit.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë si dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, ose ekuivalentev lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Çertifikatat sa më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Argumentimi:Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në sistemin e integruar të manualit për cmimet e ndertimit 2024

Shënim: Përcaktoni specififikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo

kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit

Specialist i fushes(Ing)

Jurist

Ekonomist

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR